

AKTI I THEMELIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"OLYMPIA STONE" SHPK

NENI 1 - EMERTIMI I SHOQERISE

Prej shtetasve shqiptare:

- EDMOND LALO, lindur ne Vlore me 10.06.1963 dhe banues ne Vlore ne adresen: rruga "Selam Musai" Nd.65, H.1; ---
- HERDI LALO, lindur ne Vlore me 26.07.2001 dhe po aty banues ne adresen: rruga "Selam Musai" Nd.65, H.1; -----

eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "OLYMPIA STONE" shpk

NENI 2 - QENDRA E SHOQERISE

Shoqeria "OLYMPIA STONE" shpk do te kete qendren ne Vlore ne adresen: Lagje "28 Nentori", pasuria Nr.3/43/1 ne Zonen kadastrale 8603 dhe do kete te drejte te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Shoqeria mund te krijojë agjensi, zyra perfaqsimi, qendra dytesore ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte Shtetit.

NENI 3 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte caktuar ne 100.000 leke (njëqindmijë) he eshte teresisht kapital financiar i ortakeve themelues ne raportet:

- EDMOND LALO 80% te kapitalit
- HERDI LALO 20% te kapitalit

Ortaket themelues jane zoterues te kuotave te shoqerise respektivisht:

- EDMOND LALO zoteron 1 kuote me vlere 80.000 LEKE
- HERDI LALO zoteron 1 kuote me vlere 20.000 LEKE

Me vendim te Asamblese se ortakeve kapitali mund te rritet ose zvogelohet sipas formave te parashikuara nga ligji Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtare dhe shoqerite tregtare".

NENI 4 - KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin per nje periudhe 20 vjeçare duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB deri me 01/09/2042.

Me vendim te Asamblese se ortakeve ky afat mund te zgjatet ose shoqeria mund te shkrihet para ketij afati.

NENI 5 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise do jete vijuesi:

- Nxjerrje guri nga toka dhe perpunimi i tij



- Punime te ndryshme me gur, mermer, granit dhe kuarc per subjekte private, fetare dhe publike, ---
- Prodhim, tregetim, montim memorial, buste dhe statuja, ---
- Mirembajtje dhe sherbime ne varreza private, publike (Varrezat e Deshmoreve), ----
- Prodhim dhe montim kangjella, zgara e dyer hekuri, kangjella inoksi, punime dyer dhe dritare alumili me material termik, punime dyer dritare termike prej druri, ----
- Punime dekorative mure dhe tavane me kartonxhes dhe allçi dhe veshje me pllake e pishinave

Aktivitetet tregtare mund te kryhen direkt apo ne formen e perfaqesive, si ne Shqiperi dhe jashte saj, perfshire tregtine me shumice dhe me pakice. Shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimet tregtare, industriale, te luajtshme te paluajtshme dhe te kryeje cfaredoloj aktiviteti tjeter te lejuar qe konsiderohet i nevojshem per realizimin e objektit te aktivitetit te shoqerise. Gjithashtu shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri dhe/ose kooperativa, ndermarrje te çdo natyre qe kane objekt te te njejte apo qe lidhet me objektin e veprimtarise se shoqerise.



NENI 6 - ORGANET DREJTUESE

Administrator i shoqerise per periudhen e pare 5 (pese) vjeçare nga data e sotme deri me 01.09.2027 do te jete ortaku EDMOND LALO.

Shoqeria "OLYMPIA STONE" shpk do te jete subjekt i te drejtes shqiptare dhe do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne pergjithesi, me normat e aktit themelues e te statutit bashkangjitur dhe normat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 „Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare“.

Ky akt themelimi nenshkruhet prej ortakeve themelues ne date 01/09/2022.

ORTAKET THEMELUES:

- | | | |
|-----------|------|---|
| 1. EDMOND | LALO |  |
| 2. HERDI | LALO |  |

Vlorë, më 01 shtator 2022 (dymijë e njëzet e dy)